



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.551/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së lartë Ligjore Florije Krasniqi Pireva, duke vendosur përkitazi me apelin e Murtez Rudi me vendbanim në Gjermani, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga Murtez Rudi, Zarife Rudaj, Rifat Rudaj, Teutë Rudaj dhe Shaban Rudaj me vendbanim në Gjermani, i paraqitur kundër KQZ-se për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, Urdhërohet KQZ-ja, të përfshijë apeluesit në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën **30.08.2021** PZAP-i, ka pranuar një apel nga Murtez Rudi me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se e tërë familja: Murtez Rudi, Zarife Rudaj, Rifat Rudaj, Teutë Rudaj dhe Shaban Rudaj kanë aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosove, dhe se asnjëri nga anëtarët e familjes nuk e gjejn emrin në listë për të votuar si votues jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur imazhe të dokumenteve identifikuese-pasaportave dhe formularëve si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit, e që janë pasaportat valide të Republikës së Kosovës, janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se Murtez Rudi, Zarife Rudaj, Rifat Rudaj, Teutë Rudaj dhe Shaban Rudaj, në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotësojnë kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr.551-2021 më datën 31.08.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.